



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 392 / prot.

Tiranë më 2.3.2018

Lënda: Mendim mbi “Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë”

Z. Fatmir XHAFAJ

MINISTËR I BRENDSHËM

Tiranë

I nderuar Z. Xhafaj,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1179/2 Prot., datë 23.02.2018, memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë mbi “*Shkëmbimin e informacionit për të dhënat kriminale*”, në tërësi vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Vlerësojmë se, në kapitullin V “Ndarja e informacionit”, gërma G, duhet plotësuar sipas referencës së vetë tekstit *ligji përkatës shqiptar, me formulimin: Ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Kreu II, nenet 8, 9.*

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

